

STATUTI I SHOQERISE
"ALBA CONSTRUCTION EUROPE" SH.P.K.

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 19.10.2021, personat e meposhtem:

Z. Deshir Gjetja, shtetas shqiptar, lindur me 24.10.1973 ne Tresh (LE) e banues ne Shqiperi, mbajtes i kartes se identiteti nr. 036056859, me nr. personal H310240321, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe

Shoqeria "NUOVA B.E.M. S.R.L.", shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e se drejtes italiane, me kod fiskal dhe nr. regjistrimi ne Regjistrin e Shoqerive ne Torino 04914600285, me seli Rruga "Alfonso Lamarmora" 72, CAP 10128, Torino (TO), me administrator Z. Massimo Berta, shtetas italian, lindur me 21.10.1969 ne Cuorgne (TO) dhe banues ne Prascorsano (TO), mbajtes i pashaportes me nr. YB6152379, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar;

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji 9901/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" eshte ky Statut i Shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 19.10.2021, ne, themeluesit e mesiperm, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar **"ALBA CONSTRUCTION EUROPE" SH.P.K.**

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- Tregtia si dhe ndertimi i zdrukthtarise mekanine ne pergjithesei dhe ne vecanti te pajisjeve per makinat e levizjes se tokes, perberesit te elektro-salduar dhe/ ose strukurore per makinat qe levizin token dhe makinat industriale;
- Instalimi, transformimi, shtrirja dhe mirembajtja e instalimeve dhe makinerive industriale si dhe prodhimi i tyre;

- Tregtia, koncesioni dhe perfaqesimi tregtar, prodhim i veprimtaresise se agjensise dhe i prokurimit te biznesit, ndihma dhe mirembajtja, per llogari te vet dhe te te treteve, ne Shqiperi edhe jashte vendit, te produkteve dhe aksesoreve te lidhur me produktet e mesiperme;
- Studimi i fizibilitetit te projekteve dhe analiza e sistemeve dhe mjediseve, dhenai e keshillave teknike per sa kohe qe nuk eshte ne kundershtrim me legjislacionin ne fuqi;
- Shoqeria mund te kryeje te gjitha transaksionet tregtare, financiare, te levizshme dhe te paluajtshme qe konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimve te shoqerise, perfshire percaktimin e hipotekave aktive dhe pasive, perfshire token, dhenien e mirativeve, garancive, hipotekave dhe garancive te tjera reale ose ersoanle ne favor te paleve te treta, perfshire institucionet e kreditit. Aktivitetet financiare, te cilat duhet te kryhen brenda kufinjve dhe ne perputhje me dispozitat ne fuqi here pas here, nuk mund te perbejne aktivitetin kryesor te shoqerise dhe as nuk mund te ushtrohen ndonjehere ndaj publikut.

Neni 3 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.*

Neni 4 Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga "Pjeter Bogdani", Nd.13, Kati I, Njesia Administrative 5 Tirane. Eshte e drejte e Asamblese se ortakeve te hape dege, adresa sekondare ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **LEKE 12,000 (dymbedhjete mije leke)** dhe zoterohet teresisht nga ortakët themelues si vijon:

- **Shoqeria NUOVA B.E.M. S.R.L:** Zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere te pergjithshme 9,000 Leke (nente mije leke) qe perben **75% te kapitalit themeltar te shoqerise**, dhe
- **Z. Deshir Gjetja:** Zoterues i **1 (nje) kuote** me vlere te pergjithshme 3,000 Leke (tre mije leke), qe perben **25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.**

Kontributi i ortakeve eshte ne para.

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimise; dhurimit; çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjalleve duhet të bëhet në formë noteriale dhe të regjistrohët. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandat 5 (pese) vjeçar emerimi: **Znj. Silvia Rovarin**, shtetase italiane, lindur me 10.05.1974 ne Este (PD) e e banues ne Baone (PD), mbajtes i pashaportes nr. YB3855962, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe: kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit; ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 17
Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te linden ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linden midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, ne prani te perkthyeses se gjuhes italiane, u kuptua dhe u nenshkrua nga ortaket themelues si vijon:

ORTAKET THEMELUES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALBA CONSTRUCTION EUROPE" Sh.P.K.

Deshir Gjetja



NUOVA B.E.M. S.R.L.

Perfaqesuar nga Massimo Berta



Perktheu:

